

Kontrolli i matësit

Rregullore e miratuar nga ERE mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit, kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike përcakton procedure si vijon:

- Klienti paraqet një kërkesë:
 - pranë zyrave të Operatorit të Rrjetit
 - çdo institucioni tjetër përgjegjës,
- Rregjistrimi i kërkeses nga Institucionet përgjegjëse,
- Përcjellja e kërkeses Operatorit të Rrjetit duke vënë në dijeni dhe klientin;
- Përfaqësuesi i Operatorit të Rrjetit është i detyruar të rregjistrojë kërkesën dhe të pajisë klientin me një numër unik të kërkesës së paraqitur.
- Planifikim nga Operatori i Rrjetit i realizimit të shërbimit të verifikimit të saktësisë të aparatit matës të energjisë elektrike tek klienti
- Afati 5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës

Procedura e Verifikimit

- ▶ Operatori i Rrjetit
 - Planifikon realizimin e shërbimit të verifikimit të saktësisë të aparatit matës të energjisë elektrike tek klienti jo më vonë se 5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës
 - Njofton klientin me shkrim, brenda 3 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, për ditën dhe orën kur parashikohet të kryhet verifikimi i saktësisë së matësit elektrik tek klienti.
 - Planifikon realizimin e shërbimit të verifikimit duke njoftuar DPM-në ose personin juridik të autorizuar prej saj për verifikimin e matësve elektrike, që mbulon zonën administrative të klientit që ka paraqitur kërkesën.
 - kryejnë shërbimin e verifikimit të matësit elektrik për saktësinë në bashkepunim me subjektin e autorizuar dhe në prezencë të klientit që ka paraqitur kërkesën.
 - Verifikim në terren ose në laborator

Konstatimi i gabimit në matje

- ▶ Mbasi konstatohet gabimi i matjes përtej gabimit maksimal të lejuar (minus ose plus) Operatori i Rrjetit:
 - Kryen përllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, sipas rezultatit të pasaktësisë në matës
 - Matësi që rezulton jo i rregullt do të identifikohet me anën e një çift etiketash sigurie që tregon se matësi është jo i rregullt
 - Kryen zëvendësimin e këtij matësi që rezulton jo i rregullt

- Njofton paraprakisht me shkrim klientin, brenda tre ditë pune prej ditës së verifikimit nga subjekti i autorizuar,
- Bëhet rimbursimi sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.
- Rregullimet për pasaktësitë e matjeve kufizohen për një periudhë të përcaktuar, në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Matjes.
- Klienti paraqet një ankimim pranë institucioneve përgjegjëse mbi trajtimin e kërkesës që lidhet me verifikimin e saktësisë së matësit elektrik;
- Ankimimi i kërkesës së paraqitur do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi

Detyrimet financiare të verifikimit

- ▶ Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, atëherë shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur kërkesën.
- ▶ Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit përgjegjës për energjinë, sikurse përcaktohet në Ligjin Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".